



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 54, datë 28.12.2020

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS ARSIMORE, NË BASHKINË E TIRANËS,**  
**ZONA 1, SHESHI 11/2, RRUGA “VANGJEL NOTI”**

Në mbështetje të neneve 7 shkronja “ç”, 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Përmirësimi i infrastrukturës arsimore, në Bashkinë e Tiranës, “Zona 1, Sheshi 11/2, Rruga “Vangjel Noti””, me zhvillues Bashkinë Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Vecantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.22, datë 28.02.2020 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Përmirësimi i infrastrukturës arsimore, në Bashkinë e Tiranës, Zona 1, Sheshi 11/2, Rruga “Vangjel Noti””, shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**E D I R A M A**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

